



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr. 3003/5 prot.**

**Datë 12.11.2025**

**V E N D I M**

**Nr. 1649/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                |            |
|----------------|------------|
| Fiorent Zguro  | Nënkryetar |
| Anila Malaj    | Anëtar     |
| Gjergj Mersini | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 12.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes së ankesës së operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-65394-10-16-2025, me objekt: “*Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT*”, me fond limit 9,462,524.00 Lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 27-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK me NUIS L42202028V dhe adresë: Njesia Administrative Nr. 5, Rr. Nikolla Tupe , Nd.4, H.3, Ap.13, Ap.14, Tirane.

**Autoriteti Kontraktor:**

Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A  
Rajoni Nr.1, Rruga: “Boris Plumbi”, Nr. 20, Korçë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

**Vëren:****I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II****Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 17.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-65394-10-16-2025, me objekt: “Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT”, me fond limit 9,462,524.00 Lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 27-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A

II.2. Në datën 23.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6003, protokolluar me nr. 3003/2025 prot, datë 23.10.2025, e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, me anë të së cilit kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

*“I. Objekti i kontrates është “Blerje sherbim per mirembajtjen dhe permiresimin e sistemit te faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE audit”*

*Sherbimet qe kerkohen:*

*Azhornimi, permiresimi dhe mirembajtja e Sistemit Al-Billing*

*Mirembajtja e Sistemit WAMR*

*Mirembajtja e SQL Server dhe Oracle Database, te sistemit te Faturimit Al-Billing*

*Mirembajtja e Omega Core Audit*

*Shtojca 7 FORMULARI I SHERBIMEVE DHE GRAFIKUT TE EKZEKUTIMIT*

*Sherbimet Pershkrimi Shuma Vendi i ekzekutimit*

*Afati i ekzekutimit*

*1 “Blerje sherbim per mirembajtjen dhe permiresimin e sistemit te faturimit AL-Billing, sistemit EAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT”.*

*Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce SH.A 24 (njezet e kater) muaj, duke filluar nga data e neneshkrimit te kontrates.*

*Nga kater sherbime qe kerkohen, ne shtojcen 7 ju keni listuar vetem nje sherbim qe i permbledh te kater sherbimet nderkohe qe secili nga kater sherbimet ka specifikën e vet, kohen e nevojshme per realizim, stafin e eksperteve qe do te angazhohet, koston respektive, pagesat pjesore mujore, etj.*

*Kjo sidomos behet e ndjeshme ne rastin e ofertimit te nje bashkimi operatorësh. Ndaj kerkojme qe ne formularin e shtojces 7 dhe rrjedhimisht ne formularin e ofertes te kete nje ndarje te ketyre sherbimeve.*

*II. Ne shtojcen 5. FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, Qellimi i punes, keni listuar duke e detajuar maksimalisht sherbimet mirembajtje, zhvillime dhe permiresime te Sistemit te Faturimit Al-Billing, si me poshte:*

*Pika kryesore qe do te azhornohen dhe mirembahen jane:*

*? Azhornimi i paraqitjes dhe organizimit te menuve dhe informacionit*

*? Azhornimi i menyres se identifikimit dhe administrimit te perdoruesve*

*? Shtimi i sigurise se aksesimit te sistemit nga perdoruesit duke propozuar politikat e sigurise se fjalekalimit (kompleksiteti minimal ne gjatesi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti i ndryshimit) dhe implementuar jo vetem ndryshimin e detyruar te fjalekalimit por edhe duke shtuar 2FA*

*? Azhornimi i menyres se organizimit te te dhenave per abonentet dhe informacionet e lidhura me to, orientimi ne CRM 360grade*

*? Azhornimi i menyres se organizimit te te dhenave per faturimin dhe arketimin, duke shtuar debitim kreditimin e transaksioneve*

*? Permiresimi i Sistemit te Faturimit Al-Billing per shtimin e kapacitetit te perpunimit te te dhenave te abonentëve dhe administrimit te tyre*

? Permiresimi i Sistemit te Faturimit Al-Billing per administrimin e plote te abonentit duke ndihmuar ne sakesimin e te dhenave te tij si dhe duke mundesuar lidhjen e me shume se nje kontrate per abonent

? Permiresimi i sistemit te faturimit per shtimin e dashboard-eve me analiza grafike lidhur me faturimin, arketimin, leximet dhe perdoruesit aktiv

? Permiresimi i Sistemit te Faturimit Al-Billing referuar administrimit te plote te Akt-Marrveshjeve duke mundesuar me shume se nje akt-marrveshje, analizen automatike te tyre lidhur me respektimin dhe lejuar pagesat e kesteve duke i reflektuar ato sakte ne raporte

? Per cdo kerkese apo raport qe mund te linde gjate zbatimit te kontrates te paraqitur nga AK ne lidhje me objektin e kesaj procedure prokurimi, operatori ekonomik duhet te shfaqe disponibilitetin per zgjidhjen/suportin.

? Permiresimi dhe pershtatja e formes se konsultimit per shfaqjen e te gjitha te dhenave te mundshme (kontrollin e fatures se fiskalizuar, fatures se printuar me te gjitha elementet)

? Permiresimi i Modulit te fatures Online duke reflektuar te gjitha ndryshimet e fatures apo ndryshimeve tek abonenti

? Permiresimi i Modulit te fatures Online duke shtuar identifikimin e dyfishte

? Permiresimi i Modulit te fatures Online duke shtuar certificate SSL per aksesim

? Sakesimin e te dhenave Online edhe per ankese/kerkesat apo shfaqjen e plote te te gjitha te dhenave te abonenteve

? Shtimin e opsioneve per anulimi i taksave qe te realizohen pa prekur kunsumin e ujit dhe ky proces te mund te behet nepermjet dhenies se te drejtes dhe roleve ne sistem

? Krijimin e evidencave qe pasqyron faturimin e taksave vendore te cdo muaji te ndare per secilen takse dhe njesi/zone

? Mirembajtja dhe pershtatja e formave te administrimit te abonentit dhe te dhenave te lidhura me te dhe kufizimi per marrjen e te dhenave te detyrueshme si NID, NIPT, etj.

? Mirembajtja e kontrolleve dhe pershtatjeve per njohjen dhe kontrollin e NID si element te detyrueshem

? Mirembajtja e opsionit te printimit te kontrates tip per te gjitha klientet e SHRUKK perfshire klientet ekzistues si dhe te ri

? Mirembajtja i statuseve te kontratave te abonenteve

? Mirembajtja e zonave te furnizimit dhe sakesimi i abonenteve per secilen zone dhe grup operativ

? Mirembajtja e njesive dhe te drejtave ne sistem per secilen njesi

? Mirembajtja dhe azhornimi i formes se regjistrimit te matesave dhe te formularit te montimit

? Mirembajtja, identifikimi dhe kontrolli i numrave seriale te matesave dhe njoftimi per publikata dhe mos lejimi i tyre per regjistrim

? Mirembajtja e administrimit te listes se lexuesve dhe lidhja e tyre me UK Reader ne forme Automatike referuar sinkronizimeve

? Mirembajtja e indeksimit te abonenteve sipas vendndodhjes dhe rrugeve, referuar nevojës si dhe specifikimeve te SHRUKK

? Mirembajtja ne fature e njoftimit te detyrimit si me vlere ashtu edhe me numer faturash mirembajtja e formes se kontrollit per abonente pasive dhe rasteve me anomali me qellim faturimin e sakte te taksave dhe tarifave

? Mirembajtja e formes se administrimit te tarifave qe te jene dinamike dhe ndahen ne dy tarifime referuar perqindjes se faturimit apo kerkesave te ujesjellesit, dinamike kjo mujore

? Mirembajtja e zonave dhe nenzonave te faturimit dhe pershtatja e tyre me te dhenat e Bashkive dhe Njesive Administrative

? Mirembajtja, permiresimin dhe pershtatja e formes se konsultimit per shfaqjen e te gjitha te dhenave te mundshme (kontrollin e fatures se fiskalizuar, fatures se printuar me te gjitha elementet, fotot e matesave, etj.)

? Mirembajtja dhe sakesim te raporteve per faturimin dhe debine sipas zonave dhe njesive, referuar edhe volumit te te dhenave

? Mirembajtja e arkave, bankave apo kanaleve te tjera te pagesave online si dhe lidhjeve te tyre automatikisht ne sistem

? Mirembajtja e modulit te konsultimit te fatures Online me ndryshimet e shtuara ne Sistemin Al-Billing dhe reflektimin e sakte te te dhenave

? Mirembajtja e opsionit te identifikimit nepermjet email dhe lehtesimi i konsultimit online

? Mirembajtja e te drejtave ne nivel database per perdoruesit e skemave apo menyres se sinkronizimeve

? Mirembajtja e procesit te punes duke perfshire administrimin e formave te regjistrimit nga grupet e punes ne terren

? Ngritja e alerteve automatike per akseset e pa autorizuar ne bazen e te dhenave dhe bllokimi i tyre

? Implementimi i kufizimeve me IP per te gjitha punonjesit e UKRK ne sistemin e faturimit Al-Billing

? Implementim i modulit te raportimit dinamik duke lejuar IT ne nivel perdoruesi aplikimi te krijojne raportet e nevojshme

? Rritja e nivelit te pergjithshem te sigurise ne modulet e Al-Billing dhe ne menyre te vecante te moduleve te ekspozuara Eeb service online te pagesave apo te konsultimit te faturave nga klientet

? Parapergatitja e rregulloreve per perdorimin e sistemit Al-Billing

? Parapergatitja e rregulloreve operacionale per veprimet sistemuese duke sakesuar te gjitha veprimet dhe menyren e sistemimit duke mundesuar realizimin e tyre nga aplikimi e jo ne bazen e te dhenave

? Perpilimin e dokumentit per te gjitha diagramen e qarkullimit te informacionit nepermjet sistemeve dhe moduleve

? Parapergatitja e dokumentacionit te dokumentimit te baze se te dhenave me detajet dhe elementet teknik te perfshira

? Parapergatitja e rregullores per administrimin e perdoruesve dhe ripercaktimi i roleve dhe te drejtave duke sakesuar edhe format e te drejtave referuar rregullores.

? Zhvillim te sistemit te faturimit per te pershtatur raporte arketimi dhe faturimi qe me pas te migrohet ne nje sistem financiar (sipas kriterave te vendosura nga Shoqeria)

? Zhvillim te raportit mbi pagesat kreditore per te monitoruar dhe identifikuar te gjitha pagesat qe vijne nga agjentet.

? Sistemin dhe rakordim te subvencionit, duke bere shtim te raportit sipas kerkesave nga Shoqeria

? Zhvillim ne raportet e debise ne menyre qe nje raport i caktuar debie te bllokohet per cdo ndryshim pas nje date te caktuar (data e fundit e cdo muaji).

? Shtimi i nje raporti per rakordim te listave te arketimit midis zerave te fatures me totalin e arketuar

? Ristrukturimi dhe normalizimi i bazes se te dhenave te sistemit te faturimit dhe moduleve

? Rishikimin i indekseve dhe te gjitha SQL-ve qe vonojne dhe kane nevojte per normalizim

? Azhornimi i versionit te PHP dhe azhornimi i vulnerabiliteteve

? Takim fizik per diskutim te vijimesise se mirembajtjes si dhe kerkesave te mundshme ne zyrat e SHRUKK minimalisht nje here ne muaj

? Shtimi i certifikatave te sigurise SSL per programin Al-Billing

Por ne kete shtojce mungon informacioni i detajuar per tre sherbimet e tjera qe kerkohen si me poshte:

Mirembajtja e Sistemit WAMR

Mirembajtja e SQL Server dhe Oracle Database, te sistemit te Faturimit Al-Billing

Mirembajtja e Omega Core Audit

Nese kjo eshte nje “harrese”, kerkojme plotesimin me specifikime te detajuara te pikave qe do te azhornohen dhe mirembahen per tre keto sherbime. Por mundet qe kjo te tregojte se keto sherbime, si pjese e vete objektit kryesor te sherbimit (mirembajtje, zhvillime dhe permiresime te Sistemit te Faturimit Al-Billing) nuk ka pse evidentohen si sherbime me vete.

III. Ne shtojcen 9. FORMULARI I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT, keni kerkuar:

2.1.2. Operatoret ekonomike duhet te paraqesin autorizimin e prodhuesit/autorit/distributorit te autorizuar per objektin e prokurimit ose kontrate bashkepunimi me prodhuesin e sistemeve:

? Per Programin Kompjuterik “Al Billing”

? Per sis”Omega Core Audit” te bazes se te dhenave

Autorizimi (ose Kontrata e Bashkepunimit) duhet te jete e 3 viteve te fundit si dhe te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, Eebsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Kerkesa qe autorizimet duhet te jene te tre viteve te fundit eshte e jashteligjshme. Per kete kerkesa te jashteligjshme eshte shprehur dhe e ka refuzuar KPP me vendimin e tij nr 475/2023. Bazuar ne Vendimin e sipercituar te KPP, kerkojme heqjen e kesaj kerkesa specifike nga kriteret e kualifikimit.

IV. Ne shtojcen 9. FORMULAR I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT, keni kerkuar:

2.1.3. Operatori ekonomik duhet te kete, personel teknik, prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, qe do te angazhohet ne implementimin e projektit, duke pasur njohuri te kombinuar sipas kerkesave te meposhtme:

? Punonjes te certifikuar per zhvillim dhe mirembajtje infrastrukture;

? Punonjes te certifikuar per zhvillim dhe mirembajtje e Programit Kompjuterik Al Billing

? Punonjes te certifikuar per zhvillim ne eeb/mobile;

? Punonjes te certifikuar per mirembajtjen e Sistemit Omega Core Audit

*Nje punonjes mund te posedoje me shume se nje certifikim dhe ne menyre te kombinuar mund te mbuloje me shume se nje proces pune.*

*Nuk keni vendosur numrin e stafit te kerkuar per secilen nga kategorite e certifikimit. Per te shmangur cdo paqartesi, ju lutemi percaktoni qarte numrin e stafit te kerkuar per secilen kategori certifikimi te kerkuar.*

*V. Ne shtojcen 9. FORMULAR I I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT, keni kerkuar:*

*2.1.3. Operatori ekonomik duhet te kete, personel teknik, prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, qe do te angazhohet ne implementimin e projektit, duke pasur njohuri te kombinuar sipas kerkesave te meposhtme:*

*? Punonjes te certifikuar per mirembajtjen e Sistemit Omega Core Audit*

*Nje punonjes mund te posedoje me shume se nje certifikim dhe ne menyre te kombinuar mund te mbuloje me shume se nje proces pune.*

*Sipas te dhenave rezulton qe database e juaj eshte Oracle rrjedhimisht dhe certifikata e auditit duhet te jete po Oracle.*

*Certifikata Omega Core Audit qe ju keni kerkuar rezulton te jete nje eertifikate e nje subjekti/ personi vendor e cila eshte e paregjistruar/ certifikuar nga trupa akredituese ne Shqiperi apo ato nderkombetare (Oracle/ Microsoft).*

*Kjo cenon nenin 2 Qellimi te ligjit nr. 162/2020 i ndryshuar.*

*Persa me siper kerkojme heqjen e kesaj kerkese nga kriteret e kualifikimit. ”*

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 29.10.2025 dhe në datën 31.10.2025 është protokolluar në Komsionin e Prokurimit Publik përkatësisht me nr.3003/1 prot., dhe nr. 3303/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.740/23 prot., datë 29.10.2025 me objekt: “*Shkresë përcjellëse, dërgim Vendim KSHA dhe shtojcat përkatëse me dokumentat e tenderit*”, ardhur dy herë në KPP, nëpërmjet postës elektronike dhe shërbimit postar, bashkëngjitur Vendimi nr.1 , datë 29.10.2025 dhe nr.prot., 740/15 prot., i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Referuar këtij vendimi rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka pranuar pjesërisht pretendimet e ankimuesit, dhe konkretisht ka pranuar pretendimet e ankimuesit lidhur me pikat 1, 2, 3 dhe 4 të ankesës dhe ka refuzuar pretendimet e ankimuesit të parashtruara në pikën 5 të ankesës.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-65394-10-16-2025, me objekt: “*Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT*”, me fond limit 9,462,524.00 Lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 27-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar Vendimit nr.1, datë 29.10.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, bashkëngjitur shkresës së autoritetit kontraktor nr.740/23 prot., datë 29.10.2025 me objekt: “*Shkresë përcjellëse, dërgim Vendim KSHA dhe shtojcat përkatëse me dokumentat e tenderit*”, rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka pranuar pretendimet e ankimuesit, lidhur me pikat 1, 2, 3 dhe 4 të ankesës.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

*“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argum entet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, me nr. 3003 protokoli, datë 23.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6003 datë 23.10.2025.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimesit, të parashtruara në pikën 5 të ankesës, konkretisht si vijon: “V. Ne shtojcen 9. FORMULAR I I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT, keni kerkuar: 2.1.3. Operatori ekonomik duhet te kete, personel teknik, prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, qe do te angazhohet ne implementimin e projektit, duke pasur njohuri te kombinuar sipas kerkesave te meposhtme:

? Punonjes te certifikuar per mirembajtjen e Sistemit Omega Core Audit

Nje punonjes mund te posedoje me shume se nje certifikim dhe ne menyre te kombinuar mund te mbuloje me shume se nje proces pune.

Sipas te dhenave rezulton qe database e juaj eshte Oracle rrjedhimisht dhe certifikata e auditit duhet te jete po Oracle. Certifikata Omega Core Audit qe ju keni kerkuar rezulton te jete nje certifikate e nje subjekti/ personi vendor e cila eshte e paregjistruar/ certifikuar nga trupa akredituese ne Shqiperi apo ato nderkombetare (Oracle/ Microsoft). Kjo cenon nenin 2 Qellimi te ligjit nr. 162/2020 i ndryshuar.

Persa me siper kerkojme heqjen e kesaj kerkese nga kriteret e kualifikimit.”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, pika 2.1.3 të dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit të mëposhtëm:

“2.1.3. Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të angazhohet në implementimin e projektit, duke pasur njohuri të kombinuar sipas kërkesave të mëposhtme:

- punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje infrastrukture;
- punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje e Programit Kompjuterik Al Billing
- punonjës të certifikuar për zhvillim në ëeb/mobile;
- punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim dhe në mënyrë të kombinuar mund të mbulojë me shumë se një proces pune.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

b. Listëpagesën e 3 (tre) muajve të fundit.

**Shënim:** Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- a) Mirëmbajtja e Infrastrukturës ku janë të Instaluar Sistemet si ai Al Billing, WAMR, UK Reader apo Omega Core, kërkon njohuri specifike për cilat lidhet jo vetëm me njohjen e sistemeve në vetvete por edhe me njohjen e sistemeve të tjera të operimit apo makinave virtuale. Certifikimi i këtij lloji garanton OE që infrastruktura do të mirëmbahet dhe do të sigurohet mirëmbajtja e punës. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve.
- b) Punonjësi i certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni AL-Billing nevojitet për zhvillimin, përshtajen si dhe përmiresimin e sistemit AL-Billing. Kjo kërkesë bazohet në termat e referencës së projektit ku operatori duhet të jetë në gjendje të mirëmbajë, përshtasë programin në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga SHRUKK.
- c) Punonjësi i certifikuar për zhvillim në ëeb/mobile. Kjo kërkesë mbështetet në termat e referencës së shërbimit, ku operatori duhet të jetë në gjendje të përshtasë programin në komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga SHRUKK. Sistemi AL-Billing mbështetet në teknologjinë ëeb, ndërsa disa pjesë të rëndësishme të sistemit bazohen në programin me teknologji mobile.
- d) Punonjësi i certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit. Kjo kërkesë mbështetet në termat e referencës së shërbimit, ku operatori duhet të jetë në gjendje të mirëmbajë por edhe implementojë politika të reja mbi sigurinë për identifikimin e ndërhyrjeve të pa autorizuar në bazat e të dhënave, komponentë të rëndësishëm të kërkuar nga SHRUKK.”

III.2.2. Referuar Vendimit nr.1, datë 29.10.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, rezulton se pretendimet e ankimuesit për pikën 5 të ankesës janë refuzuar nga ky komision, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“Lidhur me ankesën referuar në pikën 5, sa i takon kërkesës për personel të certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit, të përcaktuara në shtojcën 9 “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) refuzon ankesën e paraqitur në këtë pikë, duke argumentuar se:*

*Pretendimi se kërkesa për certifikatë “Omega Core Audit” bie ndesh me dispozitat e ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me argumentin se database i sistemit është Oracle dhe certifikata e kërkuar nuk është e lëshuar nga Oracle apo Microsoft, është i pabazuar.*

*Databaza e sistemit Al-Billing në pronësi të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA nuk është vetëm Oracle, por përfshin edhe SQL Server, sic përcaktohet në objektin e kontratës “Mirëmbajtja e SQL Server dhe Oracle Databaze të sistemit të faturimit Al-Billing”. Gjithashtu vlen të theksohet se nga autoriteti kontraktor është zhvilluar dhe më herët procedurë prokurimi me të njejtin objekt dhe përkatësisht procedura me nr.reference REF-02668-04-25-2024, duke patur të njejtat kriterë kualifikimi, përfshirë kërkesën për 1 (një) punonjes të certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit”. Në atë procedurë, ky kriter është plotësuar me sukses nga operatori ekonomik fitues, i cili ka paraqitur dokumentacion të noterizuar dhe të vlefshëm ligjërish, cka vërteton se certifikimi i Omega Audit është i ligjshëm dhe i aksesueshëm në tregun shqiptar. Ky certifikim ofrohet nga subjekte të licencuara në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të autorizuar për trajnim dhe pajisje me certifikata profesionale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi. Për rrjedhojë, çdo operator ekonomik ka mundësi reale dhe të barabartë për të siguruar këtë certifikim për personelin e vet teknik, përmes kanaleve të rregullta ligjore dhe të njohura nga autoritetet përkatëse. Ky fakt dëshmon qartë se kriteri në fjalë nuk është diskriminues dhe nuk kufizon konkurrencën, por është një kërkesë teknike dhe profesionale e arsyeshme, që synon të garantojë cilësinë dhe kompetencën e stafit që do të angazhohet në mirëmbajtjen e sistemit Omega Core Audit, një komponent thelbësor për sigurinë dhe integritetin e të dhënave të sistemit të faturimit të autoritetit kontraktor. Kërkesa që punonjësit të jenë të certifikuar për programet specifike rrjedh si nevojë teknike dhe ligjore, pasi bëhet fjalë për sisteme sensitive që përmbajnë të dhëna të mbrojtura dhe loge funksionale të sistemit. Aksesimi apo ndërhyrja nga persona të paautorizuar dhe të pacertifikuar mund të shkaktojë dëmtime të integritetit të programit, humbje të logeve apo manipulim të të dhënave, duke ndikuar në sigurinë dhe gjurmueshmërinë e proceseve të brendshme. Nga ana ligjore, kjo mbështetet në kërkesat e ligjit nr.25/2021 “Për sigurinë kibernetike” të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të zbatimit të tij, të cilat detyrojnë institucionet publike dhe operatorët kritikë të infrastrukturës të garantojnë që vetëm persona të kualifikuar dhe të certifikuar të kenë akses në sisteme kritike.”*

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e

prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” thuhet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III 2.4. Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “ 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton

kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.2.7. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kriterëve të kualifikimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të ligjit nr.162/2021 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, ku parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik*". Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënës i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

III.2.8. Në lidhje me kundërshtimin e ankimuesit sa i takon kërkesës për punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit, me argumentin se "*Sipas të dhënave rezultojnë nga database e juaj është Oracle rrjedhimisht dhe certifikata e auditit duhet të jete po Oracle*", nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit rezultojnë se nga ana e autoritetit kontraktor është

kërkuar të realizojë shërbimin për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL Server Oracle Data Base, OMEGA CORE AUDI. Më hollësisht kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me shërbimin e kërkuar, janë përshkruar në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, ku është kërkuar si vijon:

**Kërkohen shërbimet:** “Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT”. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë me 57,000 abonentë, përdor aktualisht për administrimin e abonentëve, faturimin, arkëtimin, ankesë/kërkesat, faturën online sistemin e faturimit AL-BILLING, Ëeb Service të Pagesave dhe atë të Leximeve për realizimin e leximeve të matësve nga Lexuesit në terren dhe administrimin e tyre (marrjen online dhe kalimin e tyre për faturim), administron edhe sistemin WAMR për administrimin e matësve smart elektronike dhe informacionit të tyre. Gjithashtu SHRUKK përdor për sigurinë dhe kontrollin e bazës së të dhënave Omega Core Audit.

Si rrjedhojë lind nevoja për kryerjen e azhornimeve, përmirësimeve dhe mirëmbajtjes së sistemeve dhe bazave të të dhënave të përmendura më lart.

#### **Azhornimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e Sistemit Al-Billing**

Kërkohet që të kryhen përmirësimet e sistemit duke përfshirur kërkesat e UKRK dhe Autoriteteve si AKSK (e quajtur azhornime dhe përmirësime në sistem), mirëmbajtjen e sistemit të faturimit aktual edhe gjatë azhornimeve. Mbeshtetjen e UKRK për të gjithë raportet e nevojshme gjatë gjithë mirëmbajtjes.

#### **Mirëmbajtja e Sistemit WAMR**

Kërkohet që të mirëmbahet sistemi i leximeve të matësve elektronike WAMR. Mirëmbajtja do të shtrihet në mirëmbajtjen e makinave virtuale ku është i instaluar Sistemi WAMR me IIS, si dhe baza e të dhënave SQL Server. Me mirëmbajtjen e sistemit WAMR sigurohet mbarëvajtja e punës së këtij sistemi dhe siguri i leximeve të matësve elektronikë të ujit.

#### **Mirëmbajtja e SQL Server dhe Oracle Database, të sistemit të Faturimit Al-Billing**

Kërkohet që të mirëmbahen bazat e të dhënave SQL Server ku bazohet sistemi WAMR dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave Oracle Database ku bazohet sistemi i faturimit Al-Billing. Mirëmbajtja e bazave të të dhënave duhet të garantojë vijueshmërinë e shërbimit dhe në rastet e problematikave zgjidhjen dhe vendosjen në funksion duke kthyer shërbimin e sistemeve Al-Billing dhe WAMR.

#### **Mirëmbajtja e Omega Core Audit**

Kërkohet që të mirëmbahet sistemi Omega Core Audit, mirëmbajtja e këtij sistemi shumë të rëndësishëm për sigurinë e aksesimit të të dhënave. Kërkesa shtrihet edhe me azhornimin dhe përmirësimin e sistemit, instalimin e versioneve të reja, si dhe duke mbuluar të gjithë aspektet e sigurisë dhe raportimit.

#### **QËLLIMI I PUNËS**

##### **1. Të përgjithshme**

Institucioni administrues pranë të cilit do të realizohet mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemin AL-BILLING, Omega Core Audit, WAMR, UK Reader, bazave të të dhënave SQL Server dhe Oracle Database do të jetë Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Rajoni Korçë (SHRUKK).

Mirëmbajtja do të mundësohet edhe nga distanca (remote), ndërsa prezantimet dhe testimet do të bëhen fizikisht në zyrat e SHRUKK së bashku me stafin e IT dhe atë përgjegjës të biznesit sipas moduleve.

### 1.1. Kërkesat funksionale

Kërkesat funksionale do të jenë të listuara sipas pikave kryesore që do të realizohen si objekt i këtij prokurimi lidhur me mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit Al-Billing (programit kompjuterik), WAMR, UK Reader, bazave të të dhënave SQL Server dhe Oracle, si dhe sistemit Omega Core Audit për Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Korçë (SHRUKK). Mirëmbajtje, zhvillime dhe përmirësime të Sistemit të Faturimit Al-Billing

Në këtë kërkesë kerkohet që të realizohet azhurnimi dhe përmirësimi i sistemit të faturimit Al-Billing, të mirëmbahet apo edhe rishikohen/përmirësohen aty ku shikohet e nevojshme të gjithë format e regjistrimit dhe administrimit të të dhënave me qëllim administrimin e informacioneve të reja si dhe azhurnimin e atyre egzistuese duke mos u kufizuar vetëm në fusha por edhe funksione.

Pika kryesore që do të azhurnohen dhe mirëmbahen janë:

- ✓ Azhurnimi i paraqitjes dhe organizimit të menuve dhe informacionit
- ✓ Azhurnimi i menyres së identifikimit dhe administrimit të përdoruesve
- ✓ Shtimi i sigurisë së aksesimit të sistemit nga përdoruesit duke propozuar politikat e sigurisë së fjalëkalimit (kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti i ndryshimit) dhe implementuar jo vetëm ndryshimin e detyruar të fjalëkalimit por edhe duke shtuar 2FA
- ✓ Azhurnimi i menyres së organizimit të të dhënave për abonentet dhe informacionet e lidhura me to, orientimi në CRM 360grade
- ✓ Azhurnimi i menyres së organizimit të të dhënave për faturimin dhe arkëtimin, duke shtuar debitim kreditimin e transaksioneve
- ✓ Përmirësimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing për shtimin e kapacitetit të përpunimit të të dhënave të abonentëve dhe administrimit të tyre
- ✓ Përmirësimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing për administrimin e plotë të abonentit duke ndihmuar në saktësimin e të dhënave të tij si dhe duke mundësuar lidhjen e më shumë se një kontrate për abonent
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e dashboard-eve me analiza grafike lidhur me faturimin, arkëtimin, leximet dhe përdoruesit aktiv
- ✓ Përmirësimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing referuar administrimit të plotë të Akt-Marrveshjeve duke mundësuar më shumë se një akt-marrveshje, analizën automatike të tyre lidhur me respektimin dhe lejuar pagesat e kësteve duke i reflektuar ato saktë në raporte
- ✓ Për çdo kërkesë apo raport që mund të lindë gjatë zbatimit të kontratës të paraqitur nga AK në lidhje me objektin e kësaj procedure prokurimi, operatori ekonomik duhet të shfaqë disponibilitetin për zgjidhjen/suportin.
- ✓ Përmirësimi dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët)
- ✓ Përmirësimi i Modullit të Faturës Online duke reflektuar të gjithë ndryshimet e faturës apo ndryshimeve tek abonenti
- ✓ Përmirësimi i Modullit të Faturës Online duke shtuar identifikimin e dyfishtë
- ✓ Përmirësimi i Modullit të Faturës Online duke shtuar certificate SSL për aksesim

- ✓ Saktësimin e të dhënave Online edhe për ankesë/kërkesat apo shfaqjen e plotë të të gjithë të dhënave të abonentëve
- ✓ Shtimin e opsioneve për anulimi i taksave që të realizohen pa prekur kunsumin e ujit dhe ky proces të mund të bëhet nëpërmjet dhënies së të drejtës dhe roleve ne sistem
- ✓ Krijimin e evidencave që pasqyron faturimin e taksave vendore të cdo muaji të ndarë për secilen taksë dhe njësi/zonë
- ✓ Mirëmbajtja dhe përshtatja e formave të administrimit të abonentit dhe të dhënave të lidhura me të dhe kufizimi për marrjen e të dhënave të detyrueshme si NID, NIPT, etj.
- ✓ Mirëmbajtja e kontrolleve dhe përshtatjeve për njohjen dhe kontrollin e NID si element të detyrueshëm
- ✓ Mirëmbajtja e opsionit të printimit të kontratës tip për të gjithë klientët e SHRUKK përfshirë klientët ekzistues si dhe të ri
- ✓ Mirëmbajtja i statuseve të kontratave të abonentëve
- ✓ Mirëmbajtja e zonave të furnizimit dhe saktësimi i abonentëve për secilën zonë dhe grup operativ
- ✓ Mirembajtja e njesive dhe te drejtave ne sistem per secilen njesi
- ✓ Mirëmbajtja dhe azhurnimi i formës së regjistrimit të matësave dhe të formularit të montimit
- ✓ Mirëmbajtja, identifikimi dhe kontrolli i numrave serialë të matësave dhe njoftimi për publikata dhe mos lejimi i tyre për regjistrim
- ✓ Mirëmbajtja e administrimit të listës së lexuesve dhe lidhja e tyre **me UK Reader** në formë automatike referuar sinkronizimeve
- ✓ Mirëmbajtja e indeksimit te abonentëve sipas vendndodhjes dhe rrugëve, referuar nevojës si dhe specifikimeve të SHRUKK
- ✓ Mirëmbajtja në faturë e njoftimit të detyrimit si me vlerë ashtu edhe me numër faturash
- ✓ Mirëmbajtja e formës së kontrollit për abonentë pasivë dhe rasteve me anomali me qëllim faturimin e saktë të taksave dhe tarifave
- ✓ Mirëmbajtja e formës së administrimit të tarifave që të jenë dinamike dhe ndahen në dy tarife referuar përqindjes së faturimit apo kërkesave të ujësjellësit, dinamike kjo mujore
- ✓ Mirëmbajtja e zonave dhe nënzonave të faturimit dhe përshtatja e tyre me të dhënat e Bashkive dhe Njësive Administrative
- ✓ Mirëmbajtja, përmirësimin dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët, fotot e matësave, etj.)
- ✓ Mirëmbajtja dhe saktësim të raporteve për faturimin dhe debinë sipas zonave dhe njësive, referuar edhe volumit të të dhënave
- ✓ Mirëmbajtja e arkave, bankave apo kanaleve të tjera të pagesave online si dhe lidhjeve të tyre automatikisht në sistem
- ✓ Mirëmbajtja e modulit të konsultimit të faturës Online me ndryshimet e shtuara në sistemin Al-Billing dhe reflektimin e saktë të të dhënave
- ✓ Mirëmbajtja e opsionit të identifikimit nëpërmjet email dhe lehtësimi i konsultimit online

- ✓ *Mirëmbajtja e të drejtave në nivel database për përdoruesit e skemave apo mënyrës së sinkronizimeve*
- ✓ *Mirëmbajtja e procesit të punës duke përfshirë administrimin e formave të regjistrimit nga grupet e punës në terren*
- ✓ *Ngritja e alerteve automatike për akseset e pa autorizuara në bazën e të dhënave dhe bllokimi i tyre*
- ✓ *Implementimi i kufizimeve me IP për të gjithë punonjësit e UKRK në sistemin e faturimit Al-Billing*
- ✓ *Implementim i modulit të raportimit dinamik duke lejuar IT në nivel përdoruesi aplikimi të krijojnë raportet e nevojshme*
- ✓ *Rritja e nivelit të përgjithshëm të sigurisë në modulet e Al-Billing dhe në mënyrë të vecantë të moduleve të ekspozuara ëb service online të pagesave apo të konsultimit të faturave nga klientet*
- ✓ *Parapërgatitja e rregulloreve për përdorimin e sistemit Al-Billing*
- ✓ *Parapërgatitja e rregulloreve operacionale për veprimet sistemuese duke saktësuar të gjithë veprimet dhe mënyrën e sistemit duke mundësuar realizimin e tyre nga aplikimi e jo në bazën e të dhënave*
- ✓ *Përpilimin e dokumentit për të gjithë diagramën e qarkullimit të informacionit nëpërmjet sistemeve dhe moduleve*
- ✓ *Parapërgatitja e dokumentacionit të dokumentimit të bazës së të dhënave me detajet dhe elementët teknik të përfshira*
- ✓ *Parapërgatitja e rregullores për administrimin e përdoruesve dhe ripërcaktimi i roleve dhe të drejtave duke saktësuar edhe format e të drejtave referuar rregullores.*
- ✓ *Zhvillim të sistemit të faturimit për të pershtatur raporte arketimi dhe faturimi që me pas të migrohet në një sistem financiar (sipas kriterëve të vendosura nga Shoqëria)*
- ✓ *Zhvillim të raportit mbi pagesat kreditore për të monitoruar dhe identifikuar të gjitha pagesat që vijnë nga agjentet.*
- ✓ *Sistemin dhe rakordim të subvencionit, duke bërë shtim të raportit sipas kërkesave nga Shoqëria*
- ✓ *Zhvillim në raportet e debise në mënyrë që një raport i caktuar debie të bllokohet për cdo ndryshim pas një date të caktuar (data e fundit e cdo muaji).*
- ✓ *Shtimi i një raporti për rakordim të listave të arketimit midis zerave të faturës me totalin e arketuar*
- ✓ *Ristrukturimi dhe normalizimi i bazës së të dhënave të sistemit të faturimit dhe moduleve*
- ✓ *Rishikimin i indekseve dhe të gjithë SQL-ve që vonojnë dhe kanë nevojë për normalizim*
- ✓ *Azhornimi i versionit të PHP dhe azhornimi i vulnerabiliteteve*
- ✓ *Takim fizik për diskutim të vijimësisë së mirëmbajtjes si dhe kërkesave të mundshme në zyrat e SHRUKK minimalisht një herë në muaj*
- ✓ *Shtimi i certifikatave të sigurisë SSL për programin Al-Billing*

**Shpjegim:** Certifikatat SSL janë komponentë të sigurisë dixhitale që përdoren për të enkriptuar komunikimin midis serverit dhe përdoruesit, duke siguruar që të dhënat që shkëmbehen (si fjalëkalime, numra kartash, informacione personale ose të sistemit) të mos mund të kapen apo manipulohen nga palë të treta. Sigurojnë komunikim të sigurt (HTTPS) mes klientit dhe serverit.

Vërtetojnë identitetin e faqes/sistemit, duke dëshmuar se po lidheni me serverin e duhur. Rrisin besueshmërinë dhe shmangin paralajmërimet e shfletuesve për faqe jo të sigurta.

Mirëmbajtja e sistemeve do të kryhet për një periudhë 2-vjeçare, ndërsa certifikatat e sigurisë SSL kanë vlefshmëri 1 vit. Për këtë arsye, kërkohet që certifikatat të rinovohen pas 1 viti gjatë periudhës së mirëmbajtjes.

## **SUPOZIMET DHE RRISQET**

### **Supozimet e Shërbimit**

Realizimi i këtij shërbimi bëhet për të patur një përfshirje totale të aktorëve kyç si në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit Al-Billing, mirëmbajtjen e Sistemit WAMR, mirëmbajtjen e SQL Server dhe Oracle Database, Mirëmbajtjen e Omega Core Audit. Përfshirja e plotë e aktorëve kyç është thelbësore për mbarëvajtjen me sukses të shërbimit.

### **Rrisqet**

Mos përfshirja e të gjithë aktorëve kyç do të sjellë mangësi në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemeve e si pasojë të ndikojë në sigurinë, punën dhe proceset e SHRUKK.

### **Siguria e Sistemit**

Kërkesat për sigurinë e sistemit janë të përcaktuara qartësisht në Sistemin Omega Core Audit dhe mirëmbajtja e këtij sistemi apo rishikimi i politikave të sigurisë janë objekt i kësaj mirëmbajtjeje.

Çdo përdorues do të njihet nga sistemi në mënyrë që ai të ketë të drejtë të hyjë në të me anë të identifikimit me përdorues unik dhe fjalëkalimin e tij personal. Vetëm pas identifikimit të tij me të drejta plotësisht të përcaktuara, ai mund të vijojë me punën.

Të gjithë të dhënat e ruajtura në aplikacion, përfshirë edhe ato të konfigurimeve si dhe të përdoruesëve të sistemit duhet të ruhen në një bazë të dhënash RDBMS e cila plotëson kërkesat në lidhje me integritetin e të dhënave dhe sigurisë.

Sistemi duhet të suportoje mjete efikente auditimin, aktivizimin e ruajtjes së historikut dhe të ndryshimeve, përcaktimin e historikut të të gjithë veprimeve të të shkuarës dhe të ardhmes (modifikim, shtim, fshirje). Ruajtja të realizohet për të dhëna specifike në tabela dhe forma të cilat mund të zgjidhen nga administratorët e sistemit.

Paralelisht me këtë proces kryhet kalimi i të dhënave të leximeve në terren në sistemin Al-Billing, nga ku përpunohen këto të dhëna dhe gjenerohet fatura mujore e cdo konsumatori. Në treg gjenden lehtësisht disa operatorë ekonomikë, që mund të ofrojnë të gjitha këto shërbime.

Gjithashtu sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se nga ana e tij është sqaruar se: “[...] Databaza e sistemit Al-Billing në pronësi të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA nuk është vetëm Oracle, por përfshin edhe SQL Server, sic përcaktohet në objektin e kontratës “Mirëmbajtja e SQL Server dhe Oracle Database të sistemit të faturimit Al-Billing”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterëve për kualifikim është në të drejtën e tij të kërkojë certifikime të operatorëve ekonomikë të cilët do të jenë fitues të mundshëm në procedurën e prokurimit e do të kryejnë shërbimin e kërkuar, duke i dhënë siguri autoritetit kontraktor në realizimin e objektit të prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit rezulton se databaza e sistemit të autoritetit kontraktor nuk është vetëm Oracle, ndaj dhe kërkesa e ankimesit për heqjen e kriterit për punonjës të

certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit, pasi sipas tij database e AK-së është Oracle, nuk qëndron.

III.2.10. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “*Certifikata Omega Core Audit qe ju keni kerkuar rezulton te jete nje certifikate e nje subjekti/ personi vendor e cila eshte e paregjistruar/ certifikuar nga trupa akredituese ne Shqiperi apo ato nderkombetare (Oracle/ Microsoft)*”, sipas autoritetit kontraktor kjo procedurë prokurimi me të njëjtin objekt është zhvilluar dhe më herët dhe përkatësisht procedura me nr.reference REF-02668-04-25-2024, duke patur të njëjtat kriteret kualifikimi, përfshirë kërkesën për 1 (një) punonjes të certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit”. Në atë procedurë, ky kriter është plotësuar me sukses nga operatori ekonomik fitues, i cili ka paraqitur dokumentacion të noterizuar dhe të vlefshëm ligjrisht, cka vërteton se certifikimi i Omega Audit është i ligjshëm dhe i aksesueshëm në tregun shqiptar. Ky certifikim ofrohet nga subjekte të licencuara në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të autorizuar për trajnim dhe pajisje me certifikata profesionale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi. Për rrjedhojë, çdo operator ekonomik ka mundësi reale dhe të barabartë për të siguruar këtë certifikim për personelin e vet teknik, përmes kanaleve të rregullta ligjore dhe të njohura nga autoritetet përkatëse.

III.2.10.1. Në nenin 75 “*Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit*” të LPP-së thuhet shprehimisht se: “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.”,

Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimiti Publik gjykon se objekti i pretendimeve të sipërcituara të operatorit ekonomik ankimues rezulton të jenë paqartësi mbi subjektet të cilat janë të autorizuar për trajnim dhe pajisje me certifikata profesionale për përdorimin dhe

mirëmbajtjen e sistemit në fjalë, ndërkohë që nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se është dhënë një përgjigje, duke sqaruar se çertifikimi ofrohet nga subjekte të licencuara në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të autorizuar për trajnim dhe pajisje me certifikata profesionale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi, por nuk sqaron në mënyrë shteruese këtë paqartësi të ankimuesit. Për pasojë, KPP gjykon se autoriteti kontraktor përveçse të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese, këto sqarime duhet tu bëhen me dije edhe ofetuesve të interesuar për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së si më sipër cituar.

K.P.P. gjykon se synimi bazë i autoritetit kontraktor në vendosjen e kriterëve për kualifikim është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e duhura për kryerjen e shërbimit të kërkuar dhe me cilësinë e kërkuar, por gjithnjë duke vlerësuar që këto kërkesa të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, me rëndësinë e tij në mbarëvajtjen e punës së autoritetit kontraktor, por mbi të gjitha bazuar në legjislacionit përkatës.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65394-10-16-2025, me objekt: “Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT”, me fond limit 9,462,524.00 Lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 27-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me vendimin e KSHA-së dhe arsyetimet e konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK.
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

